



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Prishtinë, 14 mars 2022

Për: Znj, Mappie Veldt - Foglia, Kryegjykatëse, Dhomat e Specializuara të Kosovës

Për dijeni të:

- z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës;
- znj. Fidelma Donlon, Administratore, Dhomat e Specializuara të Kosovës

Lënda: Përgjigje në lidhje me shkresën KSC-BC-2020-05

E nderuar Znj. Veldt - Foglia,

Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj për informacione në lidhje me mundësinë që viktimat e krimeve të përfitojnë kompensim sipas Urdhrit për Zhdëmtim nga Trupi Gjykses dhe duke ruajtur anonimitetin, ju informojmë si në vijim:

1. Fondi i Kompensimit

Në lidhje me çështjen e fondit për Kompensimin e viktimave të krimit, Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale¹, neni 19 paragrafi 1 (1.26), përcakton se:

"1.26. Fondi për kompensim të viktimave - fond në të cilin depozitohen mjetet nga konfiskimi i dorëzansisë dhe pasurive tjera të autorizuara më ligj. Pagesat nga fondi për

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861>

kompensim të viktimave përdoren për kompensimin e viktimave të krimit, siç caktohet me ligj”,

Respektivisht neni 62 paragrafi 1 (1.5) i Kodi i Procedurës Penale, përcakton:

“1.5. nëse gjykata nuk mund të urdhërojë kompensimin nga i pandehuri apo të pandehurit për shkak të pamundësisë së tyre për të paguar, mungesës së kompetencës së gjykatës ose vdekjes, i dëmtuari ka të drejtë që të kërkojë nga gjykata që të dërgojë urdhrin për kompensim te koordinatori i fondit për kompensimin e viktimave.”

2. Veprat penale të kompenzueshme

Në këtë drejtim, Ligji nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit² (më tutje: Ligji), në nenin 6 është e përcaktuar kategoria e veprave penale të dhunshme të kompenzueshme, të cilat janë të listuara në paragrafin 1 të nenit 6, dhe atë si në vijim:

“1.1 vrasja;

1.2. trafikimi me njerëz;

1.3. dhunimi;

1.4. keqpërdorimi seksual i fëmijëve;

1.5. veprat penale që bien brenda përkufizimit të dhunës në familje sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje”.

Pavarësisht faktit që veprat e kompenzueshme të renditura në mënyrë taksative si më lartë, paragrafi 2 i nenin 6, ndër të tjera përcakton si në vijim:

“ 2. ...Komisioni³ mund të shqyrtojë dhe vendosë për kërkesat e pranuar nga personat të cilët pretendojnë se janë viktima të veprave tjera të dhunshme të cilat për shkak të natyrës së tyre dhe pasojës së shkaktuar mund të arsyetojnë kompensimin sipas këtij Ligji, në veçanti nëse viktima është viktimë e ndjeshme.”

Nga kjo lë të kuptohet se lista e veprave penale nuk është shteruese, por i është dhënë e drejtë Komisioni, për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave për kompensim të personave të tjerë të cilët pretendojnë dhe e arsyetojnë se janë viktima të veprave të tjera të dhunshme.

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10936>

³ Komisioni për kompensimin e viktimës së krimit, siç parashihet në nenin 23 të Ligjit.

3. Kushtet për kompensim

Ndërsa paragrafi 3 i po këtij neni përcakton si në vijim:

“3. Për të pasur të drejtë në kompensim viktimat e veprave të parapara me këtë nen duhet t'i plotësojnë kushtet formale dhe materiale”

Kurse neni 7 i Ligjit përcakton se kushtet formale për të drejtën në kompensim e që janë:

*“1.1 parashtruesi i kërkesës të jetë shtetas ose banor i përhershëm i Republikës së Kosovës;
1.2. të jetë shtetas i cilitdo shtet, me të cilin Republika e Kosovës ka reciprocitet, apo;
1.3. të jetë shtetas i shtetit anëtar të BE-së.”*

Ndërsa kushtet materiale (neni 8), për të drejtën në kompensim në situatat vendore dhe situatat ndërkuftare vendore janë që vepra penale:

*“1.1. të jetë paraparë dënimi me minimum një vit burgim;
1.2. të jetë kryer në territorin e Republikës së Kosovës;
1.3. të jetë zbuluar dhe raportuar te autoriteti kompetent dhe të jetë trajtuar si veprë penale;
1.4. të mos jetë kryer nga pakujdesia;
1.5. të ketë rezultuar në vdekjen e viktimës, lëndim të rëndë trupor, dëmtim të rëndë të shëndetit fizik apo çrregullim të rëndë të shëndetit mendor;
1.6. të ketë rezultuar në dëmtim tjetër të përcaktuar me këtë Ligj, dhe;
1.7. viktimat e krimit të mos ketë mundësi të realizimit të kërkesës për kompensim nga sigurimi shëndetësor apo burime tjera.”*

Për më tepër, nëse vepra penale për të cilën kërkohet kompensim sipas Ligjit rezulton në vdekjen e viktimës, vartësit e viktimës mund të gëzojnë të drejtat e parapara me Ligj, këtë të drejtë vartësve të viktimave të krimit ua garanton paragrafi 2 i nenit 7 të Ligjit.

Vlen të ceket se është obligim ligjor që viktimat të kërkon dëmshpërblim nga i pandehuri, ku këtë obligim për viktimën e përcakton neni 10 (paragrafi 1 dhe 2) i ligjit i cili përcakton si në vijim:

“1. Para aplikimit për kompensim sipas këtij ligji, parashtruesi i kërkesës është i obliguar që, përveç rasteve të referuara në nenin 9⁴ të këtij Ligji, të kërkojë fillimisht dëmshpërblim nga i pandehuri në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

2. Në rastet kur i pandehuri vetëm pjesërisht dëmshpërblen viktimën, atëherë viktima ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për kompensim shtesë nga programi për kompensim të viktimave të krimit”.

4. Llojet e kompensimit

Në nenin 12 të Ligjit përcaktohen llojet e kompensimeve, dhe atë si në vijim:

- “1.1. lëndimet të rënda fizike apo dëmtimi i shëndetit;*
- 1.2. çrregullimet e rënda të shëndetit mendor;*
- 1.3. humbja e aftësisë për punë dhe mbajtje;*
- 1.4. shpenzimet mjekësore dhe të hospitalizimit;*
- 1.5. shpenzimet e varrimit;*
- 1.6. dëmet për pajisjet mjekësore të shkatërruara, dhe;*
- 1.7. shpenzimet procedurale për parashtrimin e kërkesës për kompensim”*

5. Kërkesa për kompensim

Kërkesa për kompensim dorëzohet në Ministri të Drejtësisë, ku si të tillë e përcakton neni 29 i Ligjit, i cili thekson si në vijim:

- 1. Kërkesa për kompensim dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë.*
- 2. Për plotësimin e kërkesës për kompensim, viktima e krimit mund të kërkojë ndihmën e mbrojtësit të viktimave apo organizatave joqeveritare që ofrojnë ndihmë juridike falas për viktima.*
- 3. Në rast të angazhimit të avokatit privat për plotësimin dhe dorëzimin e kërkesës për kompensim, Komisioni nuk do të kompensojë parashtruesin e kërkesës për tarifën e kërkuar nga avokati privat. 4. Komisioni, në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, mund të shqyrtojë edhe kërkesat për kompensim të referuara nga Gjykata.*

⁴ Ky nen rregullon qasjen e menjëhershme në kompensimin e viktimës.

6. Afatet për paraqitjen e kërkesës për kompensim

Afatet për dorëzimin e kërkesës për kompensim janë të përcaktuara në nenin 31 të ligjit, i cili thekson si në vijim:

“1 Kërkesa sipas nenit 9 të këtij Ligji do të dorëzohet më së voni brenda gjashtë (6) muajve nga data kur është zbuluar vepra e fundit penale nga e cila ka rrjedhur kërkesa për kompensim.

2. Kërkesat sipas paragrafit 2 të nenit 10 dhe paragrafët 1.2-1.5 të nenit 11 të këtij ligji, duhet të dorëzohet brenda gjashtë (6) muajve nga pranimi i vendimit të plotfuqishëm.

3. Për kërkesat sipas paragrafit 1.1 të nenit 11, afati prej gjashtë (6) muajve fillon të rrjedhë nga skadimi i afatit të dhënë sipas atij neni.

4. Përjashtimisht, nëse viktimi për shkak të dëmtimeve trupore, apo shkaqeve tjera të arsyeshme që pamundësojnë dorëzimin e kërkesës, nuk është në gjendje të dorëzojë kërkesën e tij deri në afatin e përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, ai do të dorëzojë kërkesën e tij më së voni brenda tre (3) muajsh nga dita kur arsyet për të cilat ai nuk ka qenë në gjendje të dorëzon kërkesën kanë pushuar së ekzistuari.

5. Nëse viktimi është nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, afatet sipas paragrafit 4 të këtij neni do të fillojnë të rrjedhin pasi viktimi të mbushë moshën tetëmbëdhjetë 18 vjeçare”.

7. Vendim marrja nga Komisioni për kompensim

Sa i përket çështjes së marrjes së vendimit nga ana e Komisionit, paragrafi 4 i nenit 34 të Ligjit përcakton si në vijim:

“4. Komisioni merr vendim brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e pranimi të kërkesës së plotë”.

Andaj, nga të cekurat si më lartë ju njoftojmë se:

- I. Fondi për kompensim të viktimave i përcaktuar me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale është i vetmi fond për kompensimin e viktimave të krimit;

- II. Komisioni Qeveritar për Kompensim të Viktimave të Krimit është mekanizmi përkatës ligjor për të shqyrtuar dhe vendosur për kërkesat për kompensim të viktimave të krimit;
- III. Kërkesa për kompensim dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë nga vetë viktimat, përfaqësuesi i autorizuar apo mund të referohet nga Gjykata;
- IV. Kërkesa e kompletuar duhet të dorëzohet brenda afateve të përcaktuara me ligj;
- V. Për të përfituar nga fondi i kompensimit, viktimat duhet t'i plotësojnë kriteret e ligjore të cekura më lartë;
- VI. Në lidhje me kërkesën Komisioni vendos brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Për fund, Ministria e Drejtësisë do të jetë në dispozicion për të ofruar çfarëdo sqarimi tjetër shtesë në lidhje me këtë çështje, bazuar në legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Ju faleminderit.

Me respekt,
Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

